



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 188/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Xhevdet Abazi dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkitazi për apelin e Svetlana Ostojić, për tërheqje nga lista e kandidatëve të certifikuar për anëtarë të Kuvendit komunal të Istogut nga subjekti politik Socijaldemokratija (SD), për Zgjedhjet Lokale që do të mbahen me 03.11.2013, në seancën e panelit të mbajtur me 09.10.2013, mori këtë:

## V E N D I M

**HIDHET** si i palejueshëm apeli i Svetlana Ostojić, kandidate për anëtarë të Kuvendit komunal në Istog nga subjekti politik Socijaldemokratija (SD)

### Arsyetim

Me datën 07.10.2013 PZAP-i, ka pranuar një apel nga Svetlana Ostojić, kandidate e certifikuar për anëtarë të Kuvendit komunal në Istog nga subjekti politik Socijaldemokratija (SD) me nr. rendor 011, me të cilën kërkon që të tërhiqet nga lista e kandidatëve të certifikuar për anëtarë të kuvendit komunal në Istog pasi që e njëjta gjendet në këtë listë pa pëlqimin e saj.

PZAP-i, ankesën e parashtruar nga pala ankuese e ka rikualifikuar si apel duke u bazuar në nenin 1 paragrafi 8 i Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, pasi që ka konsideruar se ankesa e dorëzuar do të trajtohet në mënyrën më të duhur si apelim.

PZAP-i, shqyrtoi lejueshmërinë e këtij apeli dhe gjeti se:

### apeli është i palejuar

Tërheqja e një kandidati nga listat e kandidatëve të certifikuar nga një subjekt politik ose nga vet kandidati është e rregulluar me LZP konkretisht me nenin 28.1 të LZP-së, ku dispozitat ligjore përcaktojnë që subjekti politik i certifikuar mund të tërhiqet nga procesi zgjedhor duke i dorëzuar kërkesën KQZ-së, për tërheqje jo më vonë se dy (2) ditë të punës para datës së caktuar për hedhje të shortit.

KQZ-ja me datën 19.09.2013, e ka hedhur shortin për renditjen e subjekteve politike në fletëvotime për Zgjedhjet Lokale të datës 03.11.2013. Andaj pala e cila ka parashtruar apel në PZAP nuk e ka shfrytëzuar të drejtën e kërkesës për tërheqje në KQZ sipas nenit 28.5 të LZP-së. Me qenë se pala ankuese nuk e ka shfrytëzuar të drejtën e lartcekur për tërheqje nga lista e kandidatëve por ka parashtruar drejtpërdrejt apel në PZAP gjë që nuk është e lejuar sipas LZP-së, PZAP-i vendosi se apeli është i palejuar prandaj duke u bazuar në nenin 9.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it si dhe 115.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa**

A nr. 188/2013 më datën 09.10.2013.

**Kryesuesi i Panelit  
Muhamet Rexha**



***Udhëzim Juridik:***

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*